



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:120352

Datë: 28.01.2025

Numri i dokumentit: 06769566

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “S.E” BI, me seli në Rahovec, kundër të paditurës Inspektorati i Punes, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.153/22 të datës 23.03.2022, jashtë seancës, me datë 28.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit “S.E” BI, me seli në Rahovec, kundër të paditurës Inspektorati i Punes, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.153/22 të datës 23.03.2022.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “S.E” BI, me seli në Rahovec, i përfaqësuar nga avokati Florid Hasku, me datë 13.06.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës Inspektorati i Punes, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.153/22 të datës 23.03.2022.

Gjykata me datë 04.12.2024 paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar paditësin “S.E” BI, me seli në Rahovec, i përfaqësuar nga avokati Florid Hasku që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’u paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi,

brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Përfaqësuesi i paditësit avokati Florid Hasku vërejtjen e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 12.12.2024, ndërsa edhe pas kalimit afatit konstatohet se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë. Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm
KA.nr.1215/22, me datë 28.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomës së shkallës së parë të kësaj Gjykate.